

QENDRA E TRANSFERIMIT TE TEKNOLOGJIVE BUJQESORE VLORE.

R A P O R T P E R F U N D I M T A R

Krijimi e fermave pilot te mbjellë me fidana të kultivarit “Kalinjot” shtuar me copa vegetative.(viti 2012)

Ferma 1 Fshati Dukat Bashkia Orikum

Ferma pilot u ngrit në fshatin Dukat, Bashkia Orikum - Vlorë, në fermën e z Bashkim Habili. Parcela është në terren fushor. Toka ka pjellori të madhe dhe me përmbajtje të lartë humusi. Fidanat u dhanë nga QTTB-Vlorë kultivarit “Kalinjot”, të prodhuar me copa vegetative, me një gjatësi 0.5-0.6 m lartësi, i pastër nga sëmundjet dhe dëmtuesit. U mbollën gjithsejt 200 fidana në një sipërfaqe prej 0.5 ha. Në vazhdimësi nga ana jonë janë ndjekur të gjitha shërbimet agroteknike të zbatuara në këtë ullishte.

Gjatë vitit 2012 kjo fermë ka qenë në monitorim të vazhdueshëm nga ana e specialistëve. Shërbimet agroteknike janë realizuar në afatet e duhura dhe me cilësi të lartë. Ullishtja është mbajtur vazhdimisht e punuar si midis rreshtit ashtu edhe në rresht. Janë kryer të gjitha shërbimet agroteknike ujitje, plehrim si dhe janë marrë masa për mbrojtjen nga sëmundjet dhe dëmtuesit e ndryshëm. Është vendosur në të gjitha bimët materiali sintetik për mbrojtjen nga Otiorrinchusi, janë realizuar tre spërkatje me preparate me bazë bakri të shoqëruara me inskticid ndaj syrit të palloit dhe tenjës jeshile të majës. Situata fitosanitare paraqitet shumë e mirë. Duke bashkëpunuar specialist dhe fermer ka aritur që në fund të vitit të vitit 2013 gjendja e parcelës të jetë e mirë me fidanë të zhvilluar.

Treguesit që u morën gjatë studimit :Në të gjithë parcelën prej 0.5 ha u caktuan 10 bimë, diagonalisht të cilat përfaqësonin mesataren për nga zhvillimi vegjetativ të të gjithë bimëve të mbjella.

1-Përçindja e zënieve. Nga verifikimet e bëra rezulton se nga 200 bimë të mbjella janë zënë 190 bimë ose 95%

2-Rritja e volumit të kurorës si dhe rritja e diametrit të trungut.

Matjet u kryen në dy periudha në mars dhe në nëntor(për të dy vite)

Matjet u kryen në 10 bimë të përzgjedhura në të gjithë parcelën duke përfaqësuar të gjithë zhvillimin e bimëve .

Nr i bimëve	Kurora Mars 2012		Kurora (nëntor) 2013		Rritja e vëllimit të kurorës %
	D (cm)	d (cm)	D (cm)	d (cm)	
Bima 1	60	88	90	130	48
Bima 2	58		80	125	66
Bima 3	40	69	70	110	47
Bima 4	67	92	92	140	68
Bima 5	70	86	88	132	74

Bima 6	59	82	85	136	58
Bima 7	55	79	82	110	69
Bima 8	65	80	85	120	70
Bima 9	50	70	78	118	61
Bima 10	60	85	89	122	69

Sic del nga te dhenat e mesiperme rezulton se kurora ka pesuar nje rritje mbi 60%



VITI 2012



VITI 2013

Detyra te lena fermerit

Të kryhen të gjitha shërbimet e nevojshme sipas një kalendari të dhënë nga ana e specialistit.

- Të monitorohet situata fitosanitare e të merren masa për spërkatjen kundër Tenjes jeshile të majës.

-Të mos përdoret herbicid në fushën e mbjellë me fidana ulliri. deri në tre vjet

-Të mos mbillen bimë perimore të familjes Solanaceae, pasi rrezikohet transmetimi i Verticiliumit të kultura e ullirit.

Ferma 2 Çeprat (Shushicë)

Në kuadër të të realizimit të rezultatis 3 (modele tekniko-ekonomike të ullishteve), të objektivit 2, të projektit 1, u ngritën në bashkëpunim edhe me D.R.B.U.M.K. Vlorë, 4 parcela “pilot”, në zona të ndryshme ekologjike të rrethit Vlorë. Parcelat u ngritën gjatë muajit mars 2012, në fshatrat Dukat i ri, (komuna Orikum), Armen (komuna Armen), Çeprat (Shushicë), dhe Vezhdanisht (komuna Vezhdanisht). Parcelat u mbollën të gjitha me kultivarin e ullirit Kalinjot, me fidana të prodhuar në serën me nebulizim. Për sejcilën parcelë u caktuan nga ana e Q.T.T.B Vlorë, specialistët që do të ndiqnin vazhdimisht ecurinë e ullishteve të mbjella.

Rezultoni se gjëndja e parcelave (falë kujdesit dhe shërbimeve të kryera nga ana e fermerëve, pronarë të këtyre parcelave), ka qënë mjaft e mirë. Ndryshim bën parcela në Armen, ku, largimi i pronarit për një kohë të gjatë, ka sjellë diferencim (në sensin negativ) të zhvillimit të bimëve me parcelat e tjera, ç’ka vërteton se sekret i suksesit qëndron tek kryerja intensive e shërbimeve agroteknike.

Parcela në fshatin Çeprat, komuna Shushice- Vlore, në fermën e z. Flamur Isufi. Treguesit kryesorë .

1-Perqindja e zenieve. Nga verifikimet e bera rezultoni se nga 200 bime të mbjella janë zene 197 bime ose 98.5%.

2-Rritja e kurores në lartësi si dhe rritja e diametrit të trungut. Të dhënat e marra paraqiten në tabelën e mëposhteme:

Bima	Lart/cm 27.04.	Lart/cm 18.07.12	Lart/cm 05.11.12	Lart/cm 17.10.13	D/cm 27.04.12	D/cm 18.07.12	D/cm 05.11.12	D/cm 17.10.13
Mesatare per bime	50.7	111	133	231	0.37	0.88	1.35	5.15

Sic del nga të dhënat e mesiperme rezultoni se lartësia e bimes dhe trashësia e trungut janë rritur 3-4 herë nga momenti i mbjelljes për një periudhë 2 vjeçare.



Në mbjellje



Dhjetor 2012



Tetor 2013

Ferma 3 Fshatin Vezhdanisht me pronar Fuat Breshani

Bimët e ullirit kanë arritur gjatësi 180 -200 cm , me trashësi në treungun e trupit 25-40 mm diametër nga 4-6 mm që ishin në momentin e mbjellies para një viti
Nga verifikimi i bimëve në parcellë të kryera ne muajin shtator rezulton që të mos kemi as një bimë mangut nga sasia prej 200 bimësh që u mbollën në vitin 2012.

Foto1.Ullishtja në fund të vitit të parë pas mbjellies



Foto2,3,4.Ullishtja në fund të vitit të dytë pas mbjellies



Dhjetor .2013

Konkluzione.

1-Perdorimi i fidanave te shtuar me copa vegetative per ngritjen e ullishtave eshte nje menyre e re e cila po zbatohet gjeresisht sot ne bote.

2-Fidani per mbjellje duhet te te kete nje lartesi jo me te madhe se 50-70 cm pasi kur ai mbillet ne vendin e perhereshem ambientohet shume me mire me kushtet e reja te tokes dhe klimes ,perfiton shume nga sherbimet agroteknike duke siguruar nje rritje te mire vegetative qysh vitin e pare.

3-Fidanat e kultivarit “Kalinjot” te prodhuar me copa vegetative me nebulizm kane nje kosto te ulet dhe nje cmim shitje qe perballohet lehte nga fermeret (200 leke) ne nje kohe qe fidanat e shartuar por edhe ata te sjelle nga jashte kushtojne nga 300leke deri ne 550 leke.

4-Fidanat e ullirit te shtuar me copa vegetative me nebulizim te kultivarit “Kalinjot” paraqesin qendrushmeri te larte ndaj tuberkulozit te ullirit (P. Sevastanoi) , semundje kjo e cila shkakton demtim te ndjeshem gjate rritjes se bimes por edhe gjate periudhes prodhuese.

5-Eshte shume e rendesishme qe ulliri te mbillet ne terrene te pershtateshme, te pasura, te kulluara dhe mundesisht te lejojne punimet e mekanizuara me synim uljen e koston.

6- Monitorimi i vazhdueshem i bimeve per prekje nga parazite te ndryshem dhe marrjen e masave per kontrollin e tyre ne kohe e me cilesi , garanton rritjen normale te ullirit.

Specialistet

Athina Llambro

Mendim Bacaj

Zaim Veshaj

Enver Brahimsulaj